



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.67, datë 21.03.2023

PËR

**“SHPALLJEN E SHTATË VENDEVE VAKANTE PËR PROCEDURËN E
TRANSFERIMIT NËPËRMJET LËVIZJES PARALELE NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 43 pikat 1 dhe 2, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “b” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 5 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e shtatë pozicioneve vakante si më poshtë:
 - a) Pozicion vakant Nr.1 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
 - b) Pozicion vakant Nr.2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
 - c) Pozicion vakant Nr.3 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
 - ç) Pozicion vakant Nr.4 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
 - d) Pozicion vakant Nr.5 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
 - dh) Pozicion vakant Nr.6 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
 - e) Pozicion vakant Nr.7 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë, kriteret që duhet të plotësojnë, afati i dorëzimit të shprehjes së interesit, dokumentacioni që duhet të dorëzojnë, si dhe adresa ku do të dorëzohen, do të njoftohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 21.03.2023.



KRYETARI

Alfred Balla